



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit
dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Pestë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave

Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave

Ushtrueses së detyrës së Shefit të ZPV-së

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Ushtruesit të detyrës së Prokurorit të

Specializuar

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	PARASHTRIMIET	3
III.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE	5
IV.	ÇËSHTJE PARAPRAKE.....	6
V.	DISKUTIM	6
A.	Vlerësimi i kërkesave.....	6
1.	Lidhja midis krimeve të pretenduara në Kërkesat dhe Aktakuzës	7
2.	Dëmi i pretenduar	17
3.	Përfundim.....	20
B.	Masat mbrojtëse	21
1.	Parashtruesit e kërkesave të Grupit A.....	21
2.	Parashtruesit e Kërkesave të Grupit B.....	26
C.	Grupimi dhe përfaqësimi juridik i përbashkët	27
D.	Pjesëmarrja në gjykim	28
VI.	VENDIM.....	29

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), bazuar në nenet 22 dhe 40 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullat 80, 113 dhe 114 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 janar 2021 dhe 6 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat ("Vendimi i Parë Kornizë") dhe Vendimin e Dytë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat ("Vendimi i Dytë Kornizë"), ku përcaktohen parimet që rregullojnë procesin e pranimit të viktimave për pjesëmarrje në proces.¹
2. Më 30 shtator 2022, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e ndryshuar të konfirmuar ("Aktakuza").²
3. Më 18 gusht 2022, 3, 14 dhe 20 tetor 2022 dhe më 9 dhjetor 2022, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave ("ZPV") dorëzoi: (i) raportin e gjashtë në lidhje me kërkesat e viktimave, me të cilin dorëzoi 50 kërkesa ("Raporti i Gjashtë");³ (ii) raportin e shtatë në lidhje me kërkesat e viktimave, me të cilin dorëzoi 46 kërkesa ("Raporti i Shtatë");⁴ (iii) raportin e tetë në lidhje me kërkesat e

¹ F00159, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 4 janar 2021; F00382, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë Kornizë mbi Parashtrimin e Kërkesave nga Viktimat*, 6 korrik 2021.

² F00999, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, Shtojcën 2, konfidenciale dhe Shtojcën 3.

³ F00930, Administratorja, *Raporti i Gjashtë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 18 gusht 2022, me Shtojcat 1-51, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁴ F01007, Administratorja, *Raporti i Shtatë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 3 tetor 2022, me Shtojcat 1-30, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

viktimave, me të cilin dorëzoi 45 kërkesa (“Raporti i Tetë”);⁵ (iv) raportin e nëntë në lidhje me kërkesat e viktimave, me të cilin dorëzoi 19 kërkesa (“Raporti i Nëntë”);⁶ dhe (v) raportin e dhjetë në lidhje me kërkesat e viktimave, me të cilin dorëzoi 10 kërkesa (“Raporti i Dhjetë”);⁷ (bashkërisht, “Raportet”).

4. Më 1 shtator 2022, Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”) parashtrori përgjigjen ndaj Raportit të Gjashtë (“Përgjigjja e Veselit”).⁸ Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe ekipet e tjera të Mbrojtjes nuk parashtruan përgjigje.

II. PARASHTRIMIET

5. ZPV-ja vlerëson se të gjitha kërkesat e dorëzuara me Raportet janë të plota,⁹ me përjashtim të tri kërkesave në Raportin e Dhjetë.¹⁰ Në lidhje me pranueshmërinë, ZPV-ja i rekomandon Trupit Gjykses: (i) të pranojë 84 parashtrues të kërkesave si viktima pjesëmarrëse në proces (“parashtruesit e kërkesave të Grupit A”);¹¹ dhe

⁵ F01037, Administratorja, *Raporti i Tetë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 14 tetor 2022, me Shtojcat 1-23, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶ F01046, Administratorja, *Raporti i Nëntë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 20 tetor 2022, me Shtojcat 1-16, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁷ F01148, Administratorja, *Raporti i Dhjetë i Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces*, 9 dhjetor 2022, me Shtojcat 1-9, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00944, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Raportit të Gjashtë të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces (F00930)*, 1 shtator 2022.

⁹ Raporti i Gjashtë, para. 21; Raporti i Shtatë, para. 25; Raporti i Tetë, para. 22; Raporti i Nëntë, para. 23.

¹⁰ Raporti i Dhjetë, para. 22-25.

¹¹ Raporti i Gjashtë (30 parashtrues të kërkesave): Raporti i Gjashtë, para. 59; Shtojca 1 e Raportit të Gjashtë; **Viktimat 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06, 110/06, 112/06, 121/06, 122/06, 123/06, 124/06, 125/06, 163/06, 180/06, 186/06, 187/06, 188/06, 191/06, 195/06, 196/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06, 202/06, 203/06, 204/06, 212/06.** Raporti i Tetë (39 parashtrues të kërkesave): Raporti i Tetë, para. 62-63; Shtojca 1 e Raportit të Tetë; **Viktimat 130/06, 131/06, 189/06, 206/06, 207/06, 208/06, 210/06, 211/06, 209/06, 214/06, 215/06, 217/06, 218/06, 219/06, 225/06, 227/06, 228/06, 221/06, 231/06, 233/06, 234/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06, 232/06, 242/06, 243/06, 244/06, 241/06, 230/06, 245/06, 246/06, 248/06, 249/06, 250/06, 240/06, 220/06.** Raporti i Nëntë (11 parashtrues të kërkesave): Raporti i Nëntë, para. 55; Shtojca 1 e Raportit të Nëntë; **Viktimat 247/06, 251/06, 252/06, 254/06, 259/06, 216/06, 261/06, 262/06, 260/06,**

(ii) të refuzojë 86 parashtrues të kërkesave për pjesëmarrje si viktimë në proces (“parashtruesit e kërkesave të Grupit B”).¹² Sa i përket përfaqësimit juridik, ZPS-ja: (i) rekomandon që parashtruesit e kërkesave të Grupit A të grupohen me viktimat tashmë të pranuar me qëllim përfaqësimit juridik të përbashkët të tyre, dhe të përfaqësohen prej mbrojtësit të viktimave të caktuar; dhe (ii) nuk bën rekomandime për parashtruesit e kërkesave të Grupit B.¹³ Sa u përket masave mbrojtëse, ZPV-ja rekomandon që: (i) parashtruesve të kërkesave të Grupit A t’u miratohet anonimiteti; dhe që (ii) emrat dhe informacioni identifikues i parashtruesve të kërkesave të Grupit B të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut.¹⁴

6. Në lidhje me Raportin e Gjashtë, Mbrojtja e Veselit thekson se parashtrimet në paragrafët 1, 5-8 dhe 10-14 të Përgjigjes së saj ndaj Raportit të Pestë të Zyrës Administrative drejtuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces, vlejnë *mutatis mutandis* edhe në lidhje me raportin aktual, dhe Përgjigjja e Veselit i përfshin ato përmes referencave, përkatësisht se Mbrojtja e Veselit: (i) nuk kundërshton pranimin e viktimave të

265/06, 266/06. Raporti i Dhjetë (4 parashtrues të kërkesave): Raporti i Dhjetë, para. 51; Shtojca 1 e Raportit të Dhjetë; **Viktimat 276/06, 268/06, 269/06, 270/06.**

¹² Raporti i Gjashtë (20 parashtrues të kërkesave): Raporti i Gjashtë, para. 60; Shtojca 1 e Raportit të Gjashtë; **Viktimat 88/06, 89/06, 90/06, 91/06, 92/06, 93/06, 94/06, 104/06, 106/06, 107/06, 109/06, 161/06, 162/06, 164/06, 165/06, 167/06, 168/06, 169/06, 170/06, 171/06.** Raporti i Shtatë (46 parashtrues të kërkesave): Raporti i Shtatë, para. 19, 42; Shtojca 1 e Raportit të Shtatë; **Viktimat 126/06, 127/06, 128/06, 129/06, 132/06, 133/06, 134/06, 135/06, 136/06, 137/06, 138/06, 139/06, 140/06, 141/06, 142/06, 143/06, 144/06, 145/06, 146/06, 147/06, 148/06, 151/06, 152/06, 153/06, 154/06, 156/06, 158/06, 159/06, 160/06, 172/06, 174/06, 175/06, 176/06, 177/06, 178/06, 179/06, 181/06, 182/06, 183/06, 184/06, 185/06, 192/06, 193/06, 194/06, 205/06, and 213/06.** Raporti i Tetë (6 parashtrues të kërkesave): Raporti i Tetë, para. 68, 71; Shtojca 1 e Raportit të Tetë; **Viktimat 155/06, 222/06, 223/06, 150/06, 224/06, and 190/06.** Raporti i Nëntë (8 parashtrues të kërkesave): Raporti i Nëntë, para. 56; Shtojca 1 e Raportit të Nëntë; **Viktimat 255/06, 256/06, 257/06, 258/06, 229/06, 253/06, 264/06, and 263/06.** Raporti i Dhjetë (6 parashtrues të kërkesave): Raporti i Dhjetë, para. 52; Shtojca 1 e Raportit të Dhjetë; **Viktimat 105/06, 149/06, 166/06, 271/06, 272/06, 273/06.**

¹³ Raporti i Gjashtë, para. 65-66, 68; Raporti i Shtatë, para. 43; Raporti i Tetë, para. 69-71; Raporti i Nëntë, para. 61-62; Raporti i Dhjetë, para. 57-58.

¹⁴ Raporti i Gjashtë, para. 72-74; Raporti i Shtatë, para. 45; Raporti i Tetë, para. 76-78; Raporti i Nëntë, para. 66-71; Raporti i Dhjetë, para. 61-67.

rekomanduara për pjesëmarrje në proces; (ii) i kërkon Trupit Gjykses t'u refuzojë masën e anonimitetit të gjitha viktimave dhe t'i kufizojë masat mbrojtëse sipas instrumenteve ligjore të DHS-së; (iii) i kërkon Trupit Gjykses të shtyjë vendimin mbi anonimitetin deri kur Gjykata e Apelit të lëshojë vendimin e vet në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm të Mbrojtjes së Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave; (iv) parashtron se ZPS-ja nuk ka arritur të japë rekomandime më vete për secilin parashtrues kërkesë; dhe (v) parashtron se rekomandimi që të gjithë parashtruesve të kërkesave t'u miratohet anonimitet i plotë është ekstrem dhe nuk mbështetet në faktet.¹⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Pjesëmarrja e viktimave trajtohet në nenin 22 dhe rregullat 80, 113 dhe 114. Trupi Gjykses bazohet në interpretimin e këtyre dispozitave në Vendimin e Parë Kornizë dhe Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, në lidhje me kriteret që një kërkesë të konsiderohet e plotë,¹⁶ kriteret e pranueshmërisë,¹⁷ standardin e vërtetimit,¹⁸ kriteret ligjore që zbatohen për miratimin e masave mbrojtëse¹⁹ dhe kriteret për ndarjen në grupe të viktimave për përfaqësimin e përbashkët juridik të tyre.²⁰

¹⁵ F00916, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Raportit të Pestë të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces (F00894)*, 4 gusht 2022, para. 1, 5-8, 10-14.

¹⁶ Vendimi i Parë Kornizë, para. 22; F00257, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* ("Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"), 21 prill 2021, konfidencial, para. 34. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00257/RED.

¹⁷ Vendimi i Parë Kornizë, para. 28, 30-39; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 42, 45, 50-55.

¹⁸ Vendimi i Parë Kornizë, para. 29; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43.

¹⁹ Vendimi i Parë Kornizë, para. 45-49; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 64, 67.

²⁰ Vendimi i Parë Kornizë, para. 42-44 (*shih gjithashtu* para. 27, 40-41, 44, dhe 49, për rolin e ZPV-së në kryerjen e vlerësimeve paraprake në lidhje me pranueshmërinë, grupimin dhe masat mbrojtëse); Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76.

8. Trupi Gjykues gjithashtu mbështetet në vendimet e Gjykatës së Apelit mbi pjesëmarrjen e viktimave në lidhje me kriterin që parashtruesit e kërkesave duhet të demonstrojnë se janë viktimë e një krimi të paraqitur në Aktakuzë; kriterin që Trupi Gjykues të japë arsyetimin e vet për refuzimin e kërkesave për pjesëmarrje; dhe në lidhje me anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në proces.²¹

IV. ÇËSHTJE PARAPRAKE

9. Kërkesa e Mbrojtjes së Veselit që Trupi Gjykues të shtyjë marrjen e vendimit mbi kërkesën e ZPV-së për anonimitet mbi bazën se ligjshmëria e saj po shqyrtohej nga Gjykata e Apelit,²² është tashmë e tejkalar meqenëse Gjykata e Apelit ka nxjerrë vendimin e vet.²³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykues do të shqyrtojë Raportin e Gjashtë në tërësi.

V. DISKUTIM

A. VLERËSIMI I KËRKESAVE

10. Pasi ka vlerësuar formularët e kërkesave dhe dokumentacionin mbështetës në Raportet e dorëzuara kundrejt kritereve të përcaktuara në Vendimin e Parë Kornizë,²⁴ Trupi Gjykues vëren se tri kërkesa të Raportit të Dhjetë janë të paplota.²⁵ Trupi Gjykues mban parasysh parashtrimet e ZPV-së se me gjithë përpjekjet e saj, nga tre parashtruesit e kërkesave nuk mori informacionin ose dokumentacionin

²¹ IA0023/F00006, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin e Veselit kundër Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* ("Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"), 15 shtator 2022, para. 51-52. Një version i korigjuar u dorëzua më të njëjtën ditë, IA023/F00006/COR.

²² Përgjigja e Veselit, para. 8; F00856, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelin të Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 28 qershor 2022, para. 18-35, 50.

²³ Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 51-52. Një version i korigjuar u dorëzua më të njëjtën ditë, IA023/F00006/COR.

²⁴ *Shih*, Vendimi i Parë Kornizë, para. 22.

²⁵ Raporti i Dhjetë, para. 24.

që mungonte, por se sidoqoftë, të gjitha kërkesat mund të konsiderohen formalisht të plota.²⁶ Trupi Gjykses gjykon se i është paraqitur informacion i mjaftueshëm për vlerësimin e këtyre kërkesave dhe rrjedhimisht do të vijojë me vlerësimin e tyre mbi bazën e informacionit të dorëzuar. Trupi Gjykses është bindur se të gjitha kërkesat e tjera janë të plota.²⁷

11. Megjithatë, për disa kërkesa, Trupi Gjykses mori versionet në anglishte vetëm të përmbledhjeve të formularëve të kërkesave.²⁸ Mungesa e përkthimeve në anglishte të disa dokumenteve nuk ndikoi në vlerësimin e Trupit Gjykses të kërkesave, meqenëse vendimi mbi kërkesat në fjalë u mor mbi bazën e materialeve të tjera të disponueshme. Gjithsesi, për të gjitha parashtrimet e ardhshme të ZPV-së, nëse do të ketë, Trupi Gjykses udhëzon ZPV-në të dorëzojë përkthimet në anglishte të të gjitha dokumenteve mbështetëse.²⁹

12. Trupi Gjykses është bindur se të gjithë parashtruesit e kërkesave për pjesëmarrje në proces si viktimë, janë persona fizikë.³⁰

1. Lidhja midis krimeve të pretenduara në Kërkesat dhe Aktakuzës

13. Trupi Gjykses thekson se, siç është konfirmuar nga Gjykata e Apelit, krimet në lidhje me të cilat një parashtrues kërkese pretendon se është viktimë, duhet të jenë brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të

²⁶ Raporti i Dhjetë, para. 24. *Shih gjithashtu* Shtojcat 4-6 të Raportit të Dhjetë.

²⁷ Raporti i Gjashtë, para. 21; Raporti i Shtatë, para. 25; Raporti i Tetë, para. 22; Raporti i Nëntë, para. 23; Raporti i Dhjetë, para. 25.

²⁸ *Shih, p.sh.*, formularët e kërkesave të viktimave 212/06, 257/06, 258/06, 263/06 dhe 264/06.

²⁹ *Shih, për ngjashmëri*, Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 39. *Shih gjithashtu* F00611, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* ("Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"), 10 dhjetor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 38, poshtëshënimi 33. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzuan më të njëjtën ditë, F00611/CONF/RED dhe F00611/RED.

³⁰ Raporti i Gjashtë, para. 25; Raporti i Shtatë, para. 29; Raporti i Tetë, para. 26; Raporti i Nëntë, para. 23; Raporti i Dhjetë, para. 25.

paraqitura në Aktakuzë.³¹ Konkretisht, Gjykata e Apelit konstatoi se “krimi ose krimet, viktimë e të cilit ose të cilave pretendon të jetë një parashtrues kërkesë, duhet të përfshihet ose të përfshihen brenda parametrave materialë, gjeografikë dhe kohorë të akuzave të përshkruara në Aktakuzë” dhe se “Lista C, e lexuar së bashku me pjesët përkatëse të Aktakuzës, ofron një përshkrim shterues të krimeve të zhdukjes me forcë për të cilat akuzohen të akuzuarit.”³²

14. Në bazë të sa më lart, një parashtrues kërkesë që pretendon se është viktimë jo e drejtpërdrejtë e krimit të zhdukjes me forcë duhet të vërtetohet *prima facie* se është anëtar i familjes së ngushtë të një personi të përmendur me emër në Listën C. Për të njëjtën arsye, një parashtrues kërkesë që pretendon se është viktimë jo e drejtpërdrejtë e krimit të vrasjes së paligjshme duhet të vërtetohet *prima facie* se është anëtar i familjes së ngushtë të një personi të përmendur me emër në Listën B.

15. Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Trupi Gjykses analizoi secilën kërkesë në bazë të Raporteve, formularëve të kërkesave, dokumentacionit mbështetës dhe pjesëve përkatëse të Aktakuzës.

(a) Parashtruesit e kërkesave të Grupit A (ZPV-ja i rekomandon për pranim)

16. Trupi Gjykses është bindur se 84 parashtrues të kërkesave të përfshira në Raportet janë viktima të krimeve që pretendohet të jenë kryer në vendndodhjet e identifikuar në Aktakuzë, dhe se krimet e pretenduara janë brenda kuadrit kohor

³¹ IA005/F00008, Gjykata e Apelit, *Vendim mbi Apelin kundër Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* (“Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”), 16 korrik 2021, para. 35; Vendimi i Parë Kornizë, para. 32; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 45.

³² Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24, 35.

të akuzave të specifikuara në Aktakuzë në lidhje me secilën vendndodhje.³³ Më konkretisht:

(a) *Viktimat e drejtpërdrejta*. **Viktimat 204/06, 209/06, 214/06, 215/06, 225/06, 221/06, 231/06, 232/06, 243/06, 244/06, 249/06, 220/06, 251/06, 252/06, 216/06, 261/06, dhe 260/06**³⁴ janë viktima të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore ose trajtimit mizor dhe/ose torturës, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] (komuna e Malishevës), Cahan, rrethi i Hasit, Shqipëri, [REDAKTUAR] (komuna e Kaçanikut), Ivajë (komuna e Kaçanikut), Likoc (komuna e Skënderajt), Budakovë (komuna e Suharekës), [REDAKTUAR] (komuna e Lipjanit), Jabllanicë (komuna e Gjakovës), dhe Tusus, Prizren (komuna e Prizrenit) në prill-nëntor 1998, në “dimrin e 1999-ës”, shkurt-qershor 1999, dhe gusht-shtator 1999.³⁵

³³ Raporti i Gjashtë: 30 parashtrues të kërkesave. Raporti i Tetë: 39 parashtrues të kërkesave. Raporti i Nëntë: 11 parashtrues të kërkesave. Raporti i Dhjetë: 4 parashtrues të kërkesave.

³⁴ Renditja e parashtruesve të kërkesave këtu dhe në pjesët vijuese të këtij vendimi është bërë sipas renditjes kronologjike të raporteve, të përmendur sipas raporteve në poshtëshënime.

³⁵ Raporti i Gjashtë: **viktima 204/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e ndalimit të paligjshëm, trajtimit çnjerëzor dhe mizor, dhe torturës, që pretendohet të jenë kryer në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë (komuna e Gjakovës) në korrik ose gusht 1998); *shih*, formulari i kërkesës dhe materiali mbështetës i **viktimit 204/06**; Shtojca 30 e Raportit të Gjashtë; *shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 63, 100; Lista A; pjesa 3. Raporti i Tetë: **viktimat: 209/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] në qershor 1999); **214/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Cahan, rrethi i Hasit, Shqipëri, midis [REDAKTUAR] 1999); **215/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në shkurt-mars 1999); **225/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar në Malishevë (komuna e Malishevës) në korrik 1998); **221/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Budakovë (komuna e Suharekës) në [REDAKTUAR]); **231/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Cahan, rrethi i Hasit, Shqipëri, në [REDAKTUAR] 1999); **232/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Likoc (komuna e Skënderajt) në “dimrin e 1999-ës” ([REDAKTUAR], prandaj Trupi Gjykses

(b) *Viktimat jo të drejtpërdrejta. Viktimat 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06, 110/06, 112/06, 121/06, 122/06, 123/06, 124/06, 125/06, 163/06, 180/06, 186/06, 187/06, 188/06, 191/06, 195/06, 196/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06, 202/06, 203/06, 212/06, 130/06, 131/06, 189/06, 206/06, 207/06, 208/06, 210/06, 211/06, 217/06, 218/06, 219/06, 225/06, 227/06, 228/06, 233/06, 234/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06, 242/06, 243/06, 244/06, 241/06, 230/06, 245/06, 246/06, 248/06, 249/06, 250/06, 240/06, 220/06, 247/06, 254/06, 259/06, 262/06, 265/06, 266/06, 267/06, 268/06, 269/06 dhe 270/06 janë viktimat jo të drejtpërdrejta të përndjekjes, burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, torturës, vrasjes së paligjshme dhe/ose zhdukjes me forcë, që pretendohet të jenë kryer në Jabllanicë (komuna e Gjakovës), Kleçkë (komuna e Lipjanit), Llapushnik (komuna e Drenasit (Gllogocit)), Drenoc (komuna e Rahovecit), shpellën e Volljakës (komuna e Klinës), Malishevë (komuna e Malishevës),*

gjykon se pretendimet e viktimës 232/06 janë brenda kuadrit kohor të vendit të krimit); **243/06** dhe **244/06** (viktimat të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe të akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Budakovë (komuna e Suharekës) [REDAKTUAR] 1999); **249/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Malishevë (komuna e Malishevës) në korrik 1998; **220/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Likoc (komuna e Skënderajt) në prill-maj 1998). *Shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse; Shtojcat 5-7, 9-11, 13, 15, 18, 20 të Raportit të Tetë. *Shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 44, 62, 67-68, 80-81, [REDAKTUAR], 99, 104, [REDAKTUAR] 118, [REDAKTUAR]; Lista A, pjesët 5, 7, 13.1, 14.1, 17.1; Raporti i Nëntë: **251/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Bajgorë (komuna e Podujevës) në gusht-shtator 1998); **252/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1999); **216/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1998); **261/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Jabllanicë (komuna e Gjakovës) në [REDAKTUAR] 1998); **260/06** (viktimë e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR], në qershor 1999). *Shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse; Shtojcat 3-4, 6-8 të Raportit të Nëntë. *Shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 63, 70, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], 106, [REDAKTUAR]; Lista A, pjesët 3.1, [REDAKTUAR], 9.

Kukës, rrethi i Kukësit, Shqipëri, Likoc (komuna e Skënderajt), Ivajë (komuna e Ferizajt), Varosh (komuna e Ferizajt), [REDAKTUAR] (komuna e Podujevës), ish-ndërtesën e MPB-së në Prizren (komuna e Prizrenit), Jeshkovë, Prizren (komuna e Prizrenit), Bajgorë (komuna e Podujevës), [REDAKTUAR], dhe [REDAKTUAR] në prill-shtator 1998 dhe shkurt-korrik 1999, kundër anëtarit ose anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre.³⁶

³⁶ **Raporti i Gjashtë: viktimat 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Jabllanicë (komuna e Gjakovës) në [REDAKTUAR] 1998); **viktimat 110/06, 112/06, 121/06, 122/06, 123/06, 124/06, 125/06, 163/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të përndjekjes, burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, veprimeve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, dhe/ose vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jenë kryer në Kleçkë (komuna e Lipjanit) në [REDAKTUAR] 1999); **viktimat 180/06, 186/06, 187/06, 188/06, 196/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06, 202/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme që pretendohet të jetë kryer në shpellën e Volljakës (komuna e Klinës) në korrik 1998 kundër anëtarëve përkatës të familjes së ngushtë të secilit prej tyre. Trupi Gjykues vëren se viktima 180/06 është gjithashtu edhe viktimë jo e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Malishevë në [REDAKTUAR] 1998. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se viktimat 196/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06 dhe 202/06 pretendojnë se janë viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Malishevë në [REDAKTUAR] 1998, por Trupi Gjykues nuk ishte në gjendje të përcaktonte përfundimisht vendndodhjen në atë zonë ku u mbajt e ndaluar viktima e drejtpërdrejtë, dhe nëse ajo vendndodhje përkon me ndonjërin nga qendrat e ndalimit të renditura në Aktakuzë.); **viktimat 191/06 dhe 212/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1999); **viktimat 195/06 dhe 203/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1998 kundër anëtarëve përkatës të familjeve të tyre); *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 1-30, 51 të Raportit të Gjashtë; *shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 44, 63, [REDAKTUAR] 67, [REDAKTUAR], 154, [REDAKTUAR]; Lista A, pjesët 3.1, 5.1, 6.2, 12.1; Lista B, pjesët [REDAKTUAR], 9-10, [REDAKTUAR]; Lista C, [REDAKTUAR]. **Raporti i Tetë: viktimat: 130/06, 131/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Llapushnik (komuna e Drenasit (Glllogocit)) në [REDAKTUAR] 1998); **189/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1998); **viktimat 206/06, 207/06, 208/06, 210/06 dhe 211/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në shpellën e Volljakës (komuna e Klinës) në korrik 1998); **217/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Jabllanicë (komuna e Gjakovës) në [REDAKTUAR] 1999); **218/06, 219/06, 225/06, 227/06, 228/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në shpellën e Volljakës (komuna e Klinës) në korrik 1998); **233/06, 234/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe të akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Kukës, rrethi i Kukësit, Shqipëri, në

17. Trupi Gjykses vëren se krahas krimeve të lartpërmendura, **viktimat 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06, 130/06, 131/06, 214/06, dhe 240/06** gjithashtu pretendojnë se janë viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme dhe/ose zhdukjes me forcë, të kryera kundër anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre, por, duke qenë se anëtarët e familjes nuk janë në mesin e viktimave të vrasjes së paligjshme dhe/ose zhdukjes me forcë të përmendura me emër në Aktakuzë, Trupi Gjykses konstaton se vrasja e paligjshme dhe/ose zhdukja me forcë e pretenduar e anëtarëve të familjes nuk përfshihen në kuadrin e akuzave.³⁷ Trupi Gjykses më

[REDAKTUAR] 1999); **242/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në Likoc (komuna e Skënderajt), në prill 1998); **243/06, 244/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjeve të paligjshme, që pretendohet të jenë kryer në [REDAKTUAR] në gusht 1998); **241/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] (komuna e Podujevës) në [REDAKTUAR] 1999); **230/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] qershor 1999); **245/06, 246/06, 248/06, 249/06, 250/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë, që pretendohet të jenë kryer në shpellën e Volljakës (komuna e Klinës) në korrik 1998; **240/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, si dhe e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Jeshkovë, Prizren (komuna e Prizrenit) në gusht 1998); **220/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në Likoc (komuna e Skënderajt) në prill ose maj 1998). *Shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse; Shtojcat 2-4, 8-9, 12, 14-20 të Raportit të Tetë; *shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 63-64, [REDAKTUAR], 82, 100, [REDAKTUAR], 119, [REDAKTUAR]; Lista A, pjesët 1.1, 3.1, 11.1, 16.1; Lista B, [REDAKTUAR]; Lista C, [REDAKTUAR]. Raporti i Nëntë: **247/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, që pretendohet të jenë kryer në Jabllanicë (komuna e Gjakovës) në [REDAKTUAR] 1998); **254/06, 259/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në Rahovec në [REDAKTUAR]); **262/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, që pretendohet të jenë kryer në Jabllanicë (komuna e Gjakovës) në [REDAKTUAR] 1998); **265/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] (komuna e Malishevës) në korrik 1998); **266/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1999). *Shih* formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse; Shtojcat 2, 5, 7, 9-10 të Raportit të Nëntë. *Shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 63, 100, 154, [REDAKTUAR]; Lista A, pjesa 3.1; Lista B, [REDAKTUAR]. Raporti i Dhjetë: **viktimat: 267/06** (viktimë jo e drejtpërdrejtë e vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] 1998; **268/06, 269/06, 270/06** (viktima jo të drejtpërdrejta të vrasjes së paligjshme, që pretendohet të jetë kryer në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në korrik 1998). *Shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse; Shtojcat 2-3 të Raportit të Dhjetë. *Shih gjithashtu*, Aktakuza, para. [REDAKTUAR]; Lista B, [REDAKTUAR].

³⁷ Raporti i Gjashtë: formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse të **viktimave 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06**; Shtojcat 2-7 të Raportit të Gjashtë. Raporti i Tetë: formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse të **viktimave 130/06, 131/06, 214/06, 240/06**; Shtojcat 2, 6, 19 të Raportit të Tetë. *Shih gjithashtu*, në lidhje me zhdukjen me forcë, Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi

tej vëren se **viktimat 191/06 dhe 267/06** gjithashtu pretendojnë se janë viktima të drejtpërdrejta të burgosjes/arrestimit dhe ndalimit të paligjshëm ose arbitrar, dhe/ose akteve të tjera çnjerëzore dhe trajtimit mizor, por, meqenëse nuk ka prova se ata u çuan në një vendndodhje të përmendur me emër në Aktakuzë, Trupi Gjykses gjykon se krimi i pretenduar nuk përfshihet në kuadrin e akuzave.³⁸ Ngjashëm, Trupi Gjykses konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme për të nxjerrë përfundim, *prima facie*, se pretendimet e renditura në vijim janë brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe/ose material të akuzave: (i) ngjarja në [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], që përshkruajnë **viktimat 234/06 dhe 239/06**; dhe (ii) incidenti që përshkruan **viktima 261/06** në lidhje me [REDAKTUAR].³⁹

(b) Parashtruesit e kërkesave të Grupit B (ZPV-ja nuk i rekomandon për pranim)

18. Trupi Gjykses nuk është bindur se 86 individët, të cilët në Raportet përbëjnë Grupin B të parashtruesve të kërkesave, kanë vërtetuar, *prima facie*, se krimet në lidhje me të cilat pretendojnë se janë viktima, janë brenda kuadrit kohor, gjeografik dhe material të akuzave të paraqitura në Aktakuzë. Në përputhje me konstatimin e Gjykatës së Apelit,⁴⁰ Trupi Gjykses jep në poshtëshënimet arsyet e mospërmbushjes së kritereve të nenit 22(1) për secilin parashtrues të cilit ose të cilës i është refuzuar kërkesa. Kjo me qëllim që parashtruesit e kërkesave të mund

Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24; Vendimi mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, para. 159-161; Aktakuza, para. 140-177; Lista B; Lista C.

³⁸ Raporti i Gjashtë: viktima 191/06 (burgosje/arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar dhe akte të tjera çnjerëzore dhe trajtim mizor në vendndodhje të panjohur); *shih*, **viktima 191/06**, formulari i kërkesës dhe dokumenti mbështetës; Shtojca 20 e Raportit të Gjashtë. Raporti i Dhjetë: viktima 267/06 (megjithëse mbajtja në ndalim [REDAKTUAR] parashtruesit të kërkesës përfshihet në kuadrin e Aktakuzës, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të konstatuar se [REDAKTUAR], është brenda kuadrit të Aktakuzës). *Shih*, formulari i kërkesës dhe materiali mbështetës i **viktimit 267/06**. *Shih gjithashtu*, Shtojca 2 e Raportit të Dhjetë.

³⁹ Raporti i Tetë: viktimat 234/06 dhe 239/06 ([REDAKTUAR]). *Shih*, formularët e kërkesave dhe dokumenti mbështetës; Shtojca 12 e Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: viktima 261/06 ([REDAKTUAR]). *Shih*, formulari i kërkesës dhe dokumenti mbështetës; Shtojca 7 e Raportit të Nëntë.

⁴⁰ Vendimi mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 38-40.

ta kenë plotësisht të qartë se pse u është refuzuar kërkesa si dhe t'u jepet mundësia të ushtrojnë të drejtën e tyre për apel, në qoftë se vendosin të apelojnë vendimin:⁴¹

(a) *Kuadri kohor. Viktimat 132/06, 133/06, 140/06, 257/06, 258/06, 263/06 dhe 271/06* nuk kanë treguar *prima facie* se krimet - viktima të të cilave pretendojnë të kenë qenë anëtarët e familjes së ngushtë të tyre - përfshihen brenda kuadrit kohor të Aktakuzës, që është mars 1998 – shtator 1999;⁴²

(b) *Kuadri gjeografik (vendet e krimit). Viktimat 88/06, 89/06, 90/06, 91/06, 92/06, 93/06, 94/06, 104/06, 106/06, 109/06, 161/06, 162/06, 165/06,⁴³ 167/06, 168/06, 169/06, 170/06, 171/06, 132/06, 134/06, 140/06, 145/06, 146/06, 147/06, 152/06, 174/06, 175/06, 176/06, 177/06, 178/06, 179/06, 205/06, 150/06, 224/06, 257/06, 258/06, 253/06, 166/06, 271/06, 272/06 dhe 273/06* nuk kanë vërtetuar *prima facie* se krimet - viktima të të cilave pretendojnë të kenë qenë ata vetë, ose anëtarët e familjes së ngushtë të tyre - përfshihen brenda kuadrit gjeografik të Aktakuzës;⁴⁴ dhe

⁴¹ Raporti i Gjashtë: 20 parashtrues të kërkesave. Raporti i Shtatë: 46 parashtrues të kërkesave. Raporti i Tetë: 6 parashtrues të kërkesave. Raporti i Nëntë: 8 parashtrues të kërkesave. Raporti i Dhjetë: 6 parashtrues të kërkesave.

⁴² Raporti i Shtatë: Datat përkatëse janë si më poshtë dhe janë jashtë kuadrit kohor të Aktakuzës: **viktima 132/06** ([REDAKTUAR]); **viktima 133/06** ([REDAKTUAR]); **viktima 140/06** ([REDAKTUAR]); *shih*, formularët e kërkesave; Shtojcat 7-8, 13, 24 të Raportit të Shtatë. Raporti i Nëntë: **viktimat 257/06, 258/06** ([REDAKTUAR]), **263/06** ([REDAKTUAR]). *Shih*, formularët e kërkesave të **viktimave 257/06, 258/06, 263/06**. *Shih gjithashtu*, Shtojcat 11-12, 16 të Raportit të Nëntë. Raporti i Dhjetë: **viktima 271/06** ([REDAKTUAR]). *Shih* formularin e kërkesës së **viktimës 271/06**; Shtojca 7 e Raportit të Dhjetë. *Shih gjithashtu*, Aktakuza, para. 16.

⁴³ Trupi Gjykses vëren se në Raportin e Gjashtë, ZPV-ja ka dhënë përshkrim të pasaktë të kërkesës së **viktimës 165/06**. Megjithatë, Trupi Gjykses ishte në gjendje të vlerëonte kërkesën në bazë të përshkrimit në Shtojcën 45 të Raportit të Gjashtë dhe formularit të kërkesës; *shih*, **viktima 165/06**, formulari i kërkesës dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojca 45 e Raportit të Gjashtë.

⁴⁴ Parashtruesit e kërkesave, të renditur në vijim, përshkruajnë vendndodhje që nuk përmenden me emër në Aktakuzë, përkatësisht: Raporti i Gjashtë: **viktima 88/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u vra në [REDAKTUAR]), **viktimat 89/06, 91/06, 92/06, 93/06, dhe 94/06** (pretendohet se viktimat e drejtpërdrejta iu nënshtruan trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës, dhe se u vranë [REDAKTUAR]), **viktima 90/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u torturua në [REDAKTUAR]), **viktimat 104/06 dhe 106/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u rrëmbye në [REDAKTUAR]); **viktimat 109/06, 161/06 dhe 162/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u çua [REDAKTUAR]), **viktima 165/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u përdhunua dhe vra në

(c) *Kuadri lëndor*.⁴⁵ **Viktimat 107/06, 164/06,⁴⁶ 126/06, 127/06, 128/06, 129/06, 133/06, 135/06, 136/06, 137/06, 138/06, 139/06, 141/06, 142/06, 143/06, 144/06, 148/06, 151/06, 153/06, 154/06, 156/06, 158/06, 159/06, 160/06, 172/06, 181/06, 182/06, 183/06, 184/06, 185/06, 192/06, 193/06, 194/06, 213/06, 155/06, 222/06, 223/06, 190/06, 229/06, 255/06, 256/06, 263/06, 264/06, 105/06⁴⁷ dhe 149/06** nuk kanë vërtetuar *prima facie* se vrasja e paligjshme dhe/ose zhdukja me forcë e pretenduar e anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre, përfshihen

[REDAKTUAR]), **viktimat 167/06 dhe 171/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u vra në [REDAKTUAR]), **viktimat 168/06, 169/06 and 170/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u vra në [REDAKTUAR]). *Shih gjithashtu*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse, Shtojcat 31-50 të Raportit të Gjashtë. Raporti i Shtatë: **viktima 132/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u vra në [REDAKTUAR]; **viktimat 134/06, 174/06, 175/06, 176/06, 177/06 dhe 178/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u vra në [REDAKTUAR]), **viktima 140/06** ([REDAKTUAR] viktimitës së drejtpërdrejtë [REDAKTUAR]), **viktima 145/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u çua në [REDAKTUAR]), **viktima 146/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë [REDAKTUAR]), **viktima 147/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë [REDAKTUAR]), **viktima 152/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u rrëmbye nga [REDAKTUAR]. Megjithëse disa vendndodhje [REDAKTUAR] përmenden konkretisht në Aktakuzë, krimet e pretenduara nuk përfshihen brenda kuadrit kohor të këtyre akuzave dhe nuk përshkruajnë një vendndodhje të përmendur me emër brenda [REDAKTUAR]); dhe **viktimat 179/06 dhe 205/06** (viktima e drejtpërdrejtë pretendohet se u rrëmbye [REDAKTUAR]); *shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse; Shtojcat 2-18, 20-22, 24-30 të Raportit të Shtatë. Raporti i Tetë: **viktimat 150/06 dhe 224/06** (informacioni nuk mjafton për të konstatuar mbi bazë *prima facie* se viktima e drejtpërdrejtë pësoi dëmin e pretenduar në lidhje me vendet e krimit në komunën e [REDAKTUAR], të paraqitura në Aktakuzë). *Shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse. *Shih gjithashtu*, Shtojca 22 e Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: **viktimat 257/06 dhe 258/06** (kufoma e viktimitës së drejtpërdrejtë u gjet në [REDAKTUAR]), **253/06** ([REDAKTUAR] nuk është ndër qendrat e ndalimit të renditura në Aktakuzë). *Shih*, formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse. *Shih gjithashtu*, Shtojcat 12-14 të Raportit të Nëntë. Raporti i Dhjetë: formularët e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse të **viktimave: 166/06** (pretendohet se viktimat e drejtpërdrejtë u vranë në [REDAKTUAR]), **271/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u rrëmbye nga [REDAKTUAR]), **272/06** (pretendohet se viktimat e drejtpërdrejtë u vranë në [REDAKTUAR]), **273/06** (pretendohet se viktima e drejtpërdrejtë u vra në [REDAKTUAR]). *Shih gjithashtu*, Shtojcat 4, 6-9 të Raportit të Dhjetë.

⁴⁵ Trupi Gjyqës thekson se në lidhje me parashtruesit e kërkesave të cilat u vlerësua se nuk përfshiheshin në kuadrin kohor dhe/ose gjeografik të Aktakuzës, Trupi Gjyqës nuk ka nevojë të vlerësojë nëse kërkesat e këtyre parashtruesve përfshihen në kuadrin lëndor.

⁴⁶ Trupi Gjyqës vëren se në Raportin e Gjashtë, ZPV-ja ka dhënë përshkrim të pasaktë të kërkesës së **viktimitës 164/06**. Megjithatë, Trupi Gjyqës ishte në gjendje të vlerësonte kërkesën në bazë të përshkrimit në Shtojcën 44 të Raportit të Gjashtë dhe formularit të kërkesës; *shih*, **viktima 164/06**, formulari i kërkesës dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojca 44 e Raportit të Gjashtë.

⁴⁷ **Viktima 105/06** gjithashtu nuk ka demonstruar mjaftueshëm lidhjen e ngushtë personale me [REDAKTUAR].

brenda kuadrit lëndor të Aktakuzës.⁴⁸ Kjo për arsye se viktimat e drejtpërdrejta që pretendohen nuk janë ndër viktimat e vrasjes së paligjshme dhe /ose zhdukjes me forcë të përmendura me emër në Listat B dhe C të Aktakuzës.⁴⁹

19. Konstatimet e mësipërme nuk ndikojnë në asnjë vendim mbi kryerjen e krimeve të paraqitura në Aktakuzë, pranueshmërinë e kërkesave të viktimave si dhe dëmin që viktimat mund të kenë pësuar si rezultat i krimeve të pretenduara, që mund të merret në të ardhmen në vijim të një ndryshimi të mundshëm të Aktakuzës apo paraqitjes së informacionit plotësues që mundëson nxjerrjen e një përfundimi se ngjarjet e përshkruara në kërkesë janë brenda kuadrit të akuzave. Trupi Gjykues nuk do të shqyrtojë kriteret e tjera të pranueshmërisë në lidhje me parashtruesit kërkesat e të cilëve janë jashtë kuadrit të akuzave.

⁴⁸ Raporti i Gjashtë: viktimat 107/06, dhe 164/06; *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentet Mbështetëse; Shtojcat 40 dhe 44 të Raportit të Gjashtë; Raporti i Shtatë: viktimat 126/06, 127/06, 128/06, 129/06, 133/06, 135/06, 136/06, 137/06, 138/06, 139/06, 141/06, 142/06, 143/06, 144/06, 151/06, 153/06, 154/06, 156/06, 158/06, 159/06, 160/06, 172/06, 181/06, 182/06, 183/06, 184/06 185/06, 192/06, 193/06, 194/06 dhe 213/06; *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse; Shtojcat 2, 4-6, 8-12, 15, 20-22, 24-25, 27-30. Trupi Gjykues vëren se, megjithëse **viktimat 148/06** ([REDAKTUAR]), **179/06** dhe **205/06** ([REDAKTUAR]) kanë vërtetuar se anëtarët e familjes së ngushtë u morën dhe çuan në vendndodhje të përmendura me emër në Aktakuzë, ata nuk kanë vërtetuar mbi bazë *prima facie* se krimet, viktima të të cilave pretendojnë të kenë qenë anëtarët e familjes së ngushtë të tyre, përfshihen brenda kuadrit lëndor të Aktakuzës. Raporti i Tetë: formularët e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse të viktimave 155/06, 222/06, 223/06 dhe 190/06; Shtojcat 21, 23 të Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: formularët e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse të viktimave 229/06, 255/06, 256/06, 263/06, 264/06; Shtojcat 11, 13, 15-16 të Raportit të Nëntë. Raporti i Dhjetë: formularët e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse të viktimave 105/06, 149/06, 271/06. *Shih gjithashtu*, Shtojcat 4-5, 7 të Raportit të Dhjetë.

⁴⁹ *Shih në përgjithësi*, Aktakuza, para. 138-175; Lista B; Lista C; Vendim mbi Apelin e Vendimit të Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 24: “Lista C, lexuar së bashku me pjesët përkatëse të Aktakuzës, ofron përshkrim shterues të krimeve të zhdukjes me forcë për të cilat akuzohen të akuzuarit” (poshtëshënimi nuk është përfshirë).

2. Dëmi i pretenduar

20. Trupi Gjykues është bindur se të gjithë parashtruesit e kërkesave në Grupin A kanë pësuar, *prima facie*, dëm si rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve të pretenduara të përshkruara prej tyre, si më poshtë:

(a) *Viktimat e drejtpërdrejta – dëm fizik, mendor dhe/ose material. Viktimat 204/06, 221/06, 209/06, 214/06, 215/06, 225/06, 231/06, 232/06, 243/06, 244/06, 249/06, 220/06, 251/06, 252/06, 216/06, 261/06 dhe 260/06* kanë pësuar personalisht dëm fizik (dhimbje trupore, mpirje, thyerje dhëmbësh, dëmtime të dëgjimit dhe shikimit, shenja lëndimesh), dëm mendor (stres, depresion, traumë dhe shqetësim) dhe dëm material (shpenzime të mjekimit), si pasojë e drejtpërdrejtë e ndalimit dhe keqtrajtimit të tyre.⁵⁰

(b) *Viktimat jo të drejtpërdrejta – dëm mendor. Viktimat 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06, 110/06, 112/06, 121/06, 122/06, 123/06, 124/06, 125/06, 163/06, 180/06, 186/06, 187/06, 188/06, 191/06, 195/06, 196/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06, 202/06, 203/06, 212/06, 130/06, 131/06, 189/06, 206/06, 207/06, 208/06, 210/06, 211/06, 217/06, 218/06, 219/06, 225/06, 227/06, 228/06, 233/06, 234/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06, 242/06, 243/06, 244/06, 241/06, 230/06, 245/06, 246/06, 248/06, 249/06, 250/06, 240/06, 220/06, 247/06, 254/06, 259/06, 262/06, 265/06, 266/06, 267/06, 268/06, 269/06 dhe 270/06* si

⁵⁰ Raporti i Gjashtë: formulari i kërkesës dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimës 204/06**; Shtojca 30 e Raportit të Gjashtë. Raporti i Tetë: formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimave: 221/06** (pretendime për dëm fizik, mendor dhe material), **209/06, 214/06, 215/06** (pretendime për dëm fizik dhe mendor), **225/06** (pretendime për dëm fizik dhe mendor), **231/06** (pretendime për dëm fizik dhe mendor), **232/06** (pretendime për dëm fizik, mendor dhe material), **243/06, 244/06, 249/06, 220/06** (pretendime për dëm fizik, mendor dhe material); Shtojcat 10-11, 13, 15, 18, 20 të Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimave: 251/06** (pretendime për dëm fizik dhe mendor), **252/06, 216/06** (pretendim për dëm mendor), **261/06** (pretendime për dëm fizik dhe mendor), **260/06** (pretendime për dëm fizik dhe mendor); Shtojcat 3-4, 6-9 të Raportit të Nëntë.

anëtarë të familjes së ngushtë,⁵¹ kanë pësuar personalisht dëm mendor (si për shembull, traumë, çrregullim të stresit pastraumatik, pikëllim, depresion, ankth, hidhërim, pagjumësi, humbje të kujtesës, makthe dhe stres) si pasojë e drejtpërdrejtë e dëmit që pretendohet të kenë pësuar viktimat e drejtpërdrejta.⁵²

21. *Të gjitha pretendimet për dëm të refuzuara.* Trupi Gjykses ka konstatuar se viktimat e mëposhtme kanë pësuar, *prima facie*, dëm. Megjithatë, ato nuk kanë vërtetuar *prima facie* se kanë pësuar edhe dëmet e mëposhtme të pretenduara si pasojë e drejtpërdrejtë e krimeve të paraqitura në Aktakuzë. Në veçanti, Trupi Gjykses vëren se viktimat jo të drejtpërdrejta **97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06,**

⁵¹ Në lidhje me **viktimën 163/06**, Trupi Gjykses vëren se, megjithëse nuk mund të prezumohet se kishte lidhje të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë [REDAKTUAR], një lidhje e tillë mund të deduktohet meqenëse viktimat e drejtpërdrejtë [REDAKTUAR]; *shih, viktimën 163/06*, formulari i kërkesës dhe dokumentet mbështetëse; Shtojca 10 e Raportit të Gjashtë. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se, megjithëse **viktimat 197/06, 198/06, 199/06 dhe 200/06** janë anëtarë të familjes së ngushtë të njëjës prej viktimave të drejtpërdrejta ([REDAKTUAR]), nuk mund të prezumohet se kishin lidhje të ngushtë me viktimat e tjera të drejtpërdrejta ([REDAKTUAR]) meqenëse nuk janë dorëzuar prova në lidhje me këtë. Sa i përket **viktimës 247/06**, Paneli vë në dukje se, megjithëse nuk mund të prezumohet se kishte lidhje të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë meqenëse viktimat e drejtpërdrejtë është [REDAKTUAR], një lidhje e tillë mund të deduktohet sepse viktimat e drejtpërdrejtë [REDAKTUAR]. Sa i përket **viktimës 266/06**, edhe pse nuk mund të prezumohet se kishte lidhje të ngushtë meqenëse viktimat e drejtpërdrejtë [REDAKTUAR], një lidhje e tillë mund të deduktohet sepse [REDAKTUAR]. Trupi Gjykses pajtohet me vlerësimin e ZPV-së se mungesa e dokumentacionit për vërtetimin e lidhjes familjare është e arsyetuar duke mbajtur parasysh rrethanat (parashtruesi i kërkesës aktualisht [REDAKTUAR]). *Shih, Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, para. 50, 53 (“...dëmi mendor mund të prezumohet, me kusht që të konstatohet në masë të mjaftueshme lidhja e ngushtë midis viktimës së drejtpërdrejtë dhe viktimës së drejtpërdrejtë”. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se “konsiderohet se familjarët e afërt (bashkëshorti, bashkëshortja, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat) kanë lidhje të ngushtë me viktimën e drejtpërdrejtë, por edhe familjarët e tjerë që kanë lidhje [të veçantë] afeksioni ose vartësie me viktimën e drejtpërdrejtë mund të konsiderohen se kanë lidhje të ngushtë”).

⁵² Raporti i Gjashtë: formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimave 97/06, 99/06-103/06, 110/06, 112/06, 121/06-125/06, 163/06, 180/06, 186/06-188/06, 191/06, 195/06-203/06, 212/06**; Shtojcat 2-29, 51 të Raportit të Gjashtë. Raporti i Tetë: formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimave 130/06, 131/06, 189/06, 206/06, 207/06, 208/06, 210/06, 211/06, 217/06, 218/06, 219/06, 225/06, 227/06, 228/06, 233/06, 234/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06, 242/06, 243/06, 244/06, 241/06, 230/06, 245/06, 246/06, 248/06, 249/06, 250/06, 240/06, 220/06**; Shtojcat 2-4, 8-9, 12, 14-20 të Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimave 247/06, 254/06, 259/06, 262/06, 265/06, 266/06**; Shtojcat 2, 5, 7, 9-10 të Raportit të Nëntë. Raporti i Dhjetë: **viktimat 267/06** (dëm mendor dhe fizik), formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës i **viktimave 268/06, 269/06, 270/06**; Shtojcat 2-3 të Raportit të Dhjetë.

103/06, 110/06,⁵³ 112/06, 163/06, 180/06, 186/06, 187/06, 188/06, 191/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06, 202/06, 189/06, 206/06, 207/06, 208/06, 210/06, 211/06, 217/06, 218/06, 219/06, 225/06, 227/06, 228/06, 233/06, 234/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06, 242/06, 243/06, 244/06, 245/06, 246/06, 248/06, 249/06, 250/06, 220/06, 247/06, 254/06, 266/06, 267/06, 268/06, 269/06, dhe 270/06 gjithashtu pretendojnë dëm fizik dhe/ose material,⁵⁴ dhe se **viktimat 191/06, 204/06, 209/06, 215/06, 252/06,** dhe **216/06** si viktimat të drejtpërdrejta gjithashtu pretendojnë dëm fizik dhe/ose material,⁵⁵ për të cilin nuk ka informacion të mjaftueshëm për të konstatuar se

⁵³ Trupi Gjykes vëren se, megjithëse **viktima 110/06** ka dorëzuar dokumente mbështetëse në lidhje me dëmin fizik, formulari i kërkesës dhe dokumentacioni mbështetës nuk i mundësojnë Trupit Gjykes të konstatojë se dëmin fizik të pretenduar, parashtruesi i kërkesës e pësoi si pasojë e krimeve të paraqitura në Aktakuzë. Megjithatë, Trupi Gjykes vëren se **viktima 110/06** ka vërtetuar se ka pësuar dëm mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e krimeve të paraqitura në Aktakuzë. Trupi Gjykes rrjedhimisht është bindur se nuk dëmtohet mundësia e parashtruesit të kërkesës për të marrë pjesë në proces.

⁵⁴ Raporti i Gjashtë: viktimat 97/06, 100/06, 101/06, 102/06 dhe 103/06 (pretendime për dëm material), 99/06 (pretendime për dëm fizik), 110/06, 112/06 dhe 163/06 (pretendime për dëm material), 180/06 (pretendime për dëm material), 186/06, 187/06 dhe 188/06 (pretendime për dëm material), 191/06 (pretendime për dëm material), 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06 dhe 202/06 (pretendime për dëm material); *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 2-10, 16-20, 22-28 të Raportit të Gjashtë. Raporti i Tetë: viktimat 189/06 (pretendime për dëm material), 206/06, 207/06, 208/06, 210/06 dhe 211/06 (pretendime për dëm material), 215/06 (pretendime për dëm material), 217/06 (pretendime për dëm material), 218/06 dhe 219/06 (pretendime për dëm fizik dhe material), 225/06, 227/06 dhe 228/06 (pretendime për dëm material), 233/06, 235/06, 236/06, 237/06, 238/06, 239/06, 242/06 (pretendime për dëm material), 243/06 (pretendime për dëm material), 244/06 (pretendime për dëm material), 220/06 (pretendime për dëm material), 245/06 (pretendime për dëm material), 246/06 (pretendime për dëm material), 248/06 (pretendime për dëm material), 250/06 (pretendime për dëm material dhe fizik); *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 3-4, 8-9, 12, 14-15, 18, 20 të Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: viktimat 247/06 (pretendime për dëm material), 254/06 (pretendime për dëm material), 266/06 (pretendime për dëm material); *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 2, 5, 10 të Raportit të Nëntë. Raporti i Dhjetë: viktimat 267/06 (pretendime për dëm material), 268/06, 269/06 dhe 270/06 (pretendime për dëm material); *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 2-3 të Raportit të Dhjetë.

⁵⁵ Raporti i Gjashtë: viktima 191/06 (pretendon dëm fizik si rezultat i keqtrajtimit të pretenduar të tij gjatë marrjes në pyetje, por, duke qenë se Trupi Gjykes ka konstatuar se **viktima 191/06** nuk është viktimë e drejtpërdrejtë e një krimi të pretenduar, dëmi fizik i pretenduar nuk lidhet me ndonjërin nga vendndodhjet e paraqitura në Aktakuzë); **viktima 204/06** (pretendime për dëm material); *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumenti mbështetës; Shtojcat 20, 30 të Raportit të Gjashtë. Raporti i Tetë: viktimat: 209/06 (dëmi fizik dhe material lidhet me ngjarje që janë jashtë kuadrit kohor të Aktakuzës), 214/06, 249/06 (pretendime për dëm material), *shih*, formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 5-6, 18 të Raportit të Tetë. Raporti i Nëntë: viktimat: 252/06 (pretendime për dëm material); **216/06** (pretendime për dëm material); *shih* formularët e kërkesave dhe dokumentacioni mbështetës; Shtojcat 4, 6 të Raportit të Nëntë.

dëmi lidhet me një krim të paraqitur në Aktakuzë. Ky konstatim nuk ndikon negativisht në mundësinë e këtyre viktimave për pjesëmarrje në proces.

22. Së fundi, Trupi Gjykes vëren se krahas dëmit mendor dhe/ose fizik, **viktimat 212/06, 195/06, 203/06, 240/06, 234/06, 221/06, 225/06 dhe 260/06** gjithashtu pretendojnë dëm material të pësuar ndër të tjera përmes humbjes së të ardhurave, zhvlerësimit të pronës, ose rrethanave të tjera specifike.⁵⁶ Duke qenë se dëmi fizik dhe/ose mendor është provuar në shkallën e duhur në lidhje me këto viktima në këtë fazë, Trupi Gjykes nuk ka nevojë të bëjë konstatime për dëmin material të pretenduar prej këtyre viktimave. Konstatime të tilla do të bëhen në urdhrin për zhdëmtim, nëse do të ketë.

23. Konstatimet e mësipërme në lidhje me dëmet nuk ndikojnë në asnjë vendim të ardhshëm që mund të merret pas dorëzimit të materialeve shtesë.

3. Përfundim

24. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se ka prova *prima facie* se të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A kanë pësuar dëm si pasojë e drejtpërdrejtë e krimeve të pretenduara në Aktakuzë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes i pranon të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A si viktima pjesëmarrëse në proces.

25. Trupi Gjykes gjithashtu konstaton se parashtruesit e kërkesave të Grupit B, për arsyet e shtjelluara në paragrafin 18, nuk pranohen si viktima pjesëmarrëse në proces.

⁵⁶ Shih formularët e kërkesave të viktimave. Shih gjithashtu, Shtojcat 21, 29, 51 të Raportit të Gjashtë; Shtojcat 9-10, 12, 19 të Raportit të Tetë.

B. MASAT MBROJTËSE

1. Parashtruesit e kërkesave të Grupit A

26. ZPV-ja rekomandon që të gjithë parashtruesve të kërkesave të Grupit A t'u miratohet anonimitet në bazë të rregullës 80(4)(e)(i).⁵⁷

27. Mbrojtja e Veselit u referohet parashtrimeve të veta në Përgjigjen e Veselit ndaj Raportit të Pestë të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces (F00894), ku kundërshton rekomandimin e ZPV-së për miratimin e masës së anonimitetit për të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A. Në veçanti, Mbrojtja e Veselit argumenton se: (i) ZPV-ja nuk kreu vlerësim rast pas rasti për secilën viktimë; (ii) kjo qasje është në kundërshtim me kërkesat e ZPS-së për masa mbrojtëse në lidhje me dëshmitarët; (iii) masat mbrojtëse të kërkuara nuk mbështeten nga faktet meqenëse shumë viktima nuk kanë kërkuar anonimitet dhe nuk ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme, dhe se, sido që të jetë, frika subjektive e disa dëshmitarëve nuk mund të peshojë më shumë se të drejtat e të akuzuarve për gjykim të drejtë; dhe (iv) rekomandimi i ZPV-së nuk është proporcional me të drejtat e të akuzuarve.⁵⁸

28. Trupi Gjykses vëren se në Vendimin e Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi dhe hodhi poshtë pikërisht këto argumente të Mbrojtjes së Veselit.⁵⁹ Trupi Gjykses pajtohet me arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe gjithashtu vëren se kodet e dëshmitarëve dhe – me përjashtim kur në rrethana të jashtëzakonshme u miratohet anonimitet – identitetet e të gjithë dëshmitarëve me status të dyfishtë, u janë bërë të ditura ose do t'u bëhen të ditura palëve.

⁵⁷ Raporti i Gjashtë, para. 72; Raporti i Tetë, para. 76; Raporti i Nëntë, para. 69; Raporti i Dhjetë, para. 65.

⁵⁸ Përgjigjja e Veselit, para. 1 i referohet F00916, Mbrojtësi i Specializuar, Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj Raportit të Pestë të Zyrës Administrative në lidhje me Kërkesat e Viktimave për Pjesëmarrje në Proces (F00894), 4 gusht 2022, para. 7-12.

⁵⁹ Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50-55.

29. Për këto arsye, Trupi Gjykses hedh poshtë parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit dhe do të vijojë me vlerësimin e kërkesës së ZPV-së për masa mbrojtëse.

(a) Formularët e kërkesave

30. Trupi Gjykses vë në dukje se, në pajtim me rregullën 113(1), të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe dokumentet mbështetëse mbeten rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.⁶⁰ Kjo nuk ndikon në çështjen në shqyrtim e sipër të qasjes së Mbrojtjes në formularët e kërkesave të viktimave dhe kushtet.

(b) Identitetet e parashtruesve të kërkesave

31. Sikurse theksohet në Vendimin e Parë Kornizë, standardi ligjor që zbatohet për masat mbrojtëse në lidhje me viktimat është i njëjti standard që zbatohet në lidhje me dëshmitarët.⁶¹

32. Gjatë shqyrtimit të ekzistencës së rrezikut objektivisht të arsyetueshëm dhe domosdoshmërisë së masave mbrojtëse për parashtruesit e kërkesave të Grupit A, Trupi Gjykses mban parasysh këta faktorë konkretë: (i) të gjithë ata vazhdojnë të vuajnë nga trauma fizike dhe/ose mendore si rezultat i krimeve të pretenduara, viktimë e të cilave pretendohet se kanë qenë ata vetë ose anëtarët e familjeve të tyre;⁶² (ii) të gjithë parashtruesit e kërkesave, me përjashtim të gjashtë prej tyre,⁶³ kanë shprehur shqetësimin se nxjerrja e identiteteve të tyre për ZPS-në, publikun,

⁶⁰ *Shih*, F01237, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 28.

⁶¹ Vendimi i Parë Kornizë, para. 47; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 67; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 50; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 42; F00817, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave* ("Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave"), 25 maj 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 42. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00817/RED.

⁶² *Shih më lart*, para. 20.

⁶³ Raporti i Gjashtë: formularët e kërkesave të viktimave 99/06, 186/06, 187/06, 188/06 dhe 196/06; Raporti i Nëntë: formulari i kërkesës i viktimës 247/06.

mbrojtësit dhe/ose të akuzuarit, mund t'i rrezikojë ata ose familjet e tyre;⁶⁴ dhe (iii) së paku [REDAKTUAR] parashtrues të kërkesave vazhdojnë të jetojnë në Kosovë ose kanë anëtarë të familjes që jetojnë atje.⁶⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykues ka marrë parasysh: (i) atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve dhe viktimave që mbizotëron në Kosovë, sidomos në proceset penale kundër ish-anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;⁶⁶ dhe (ii) mjetet dhe motivet e të akuzuarve për t'i frikësuar viktimat, duke marrë parasysh postet me pushtet që kanë mbajtur gjatë periudhës kohore që përfshijnë akuzat, si dhe kohët e fundit.⁶⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykues mban parasysh se: (i) për shkak të statusit të tyre si viktimë pjesëmarrëse në proces, këta individë janë veçanërisht të cënueshëm dhe masat mbrojtëse duhet t'u përgjigjen nevojave të tyre të veçanta si viktimë; dhe se (ii) masat adekuate mbrojtëse për viktimat shpesh janë mjete juridik përmes të cilit mund të sigurohet pjesëmarrja e tyre në proces dhe masa të tilla janë një hap i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre, në pajtim me rregullën 80 të Rregullores.⁶⁸

⁶⁴ *Shih*, të gjithë formularët e kërkesave të parashtruesve të kërkesave të Grupit A, përveç atyre të parashtruesve të kërkesave të përmendur në poshtëshënimin pararendës.

⁶⁵ Raporti i Gjashtë: formularët e kërkesave dhe materialet mbështetëse [REDAKTUAR]; Raporti i Tetë: formularët e kërkesave [REDAKTUAR]. Raporti i Nëntë: formularët e kërkesave [REDAKTUAR].

⁶⁶ *Shih* IA015/F00005, Gjykata e Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer të Paraburgimit dhe Rishikimin e Rregullt të Mbajtjes në Paraburgim*, 25 mars 2022, para. 43; KSC-BC-2020-07, F00611, Trupi Gjykues II, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit*, 18 maj 2022, para. 577-581, 593, 646-645, 968; KSC-BC-2020-05, F00494, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit*, 16 dhjetor 2022, para. 50; F01212, Trupi Gjykues II, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Jakup Krasniqit*, 17 janar 2023, konfidencial, para. 22-23. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F01212/RED; F01213, Trupi Gjykues II, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Rexhep Selimit*, 17 janar 2023, konfidencial, para. 24-25. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 18 janar 2023, F01213/RED. KSC-CA-2022-01, F00114, Dhoma e Apelit, *Aktgjykim i Apelit*, 2 shkurt 2023, para. 424, 438.

⁶⁷ *Shih*, Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 51; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 59.

⁶⁸ *Shih*, Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 68; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 51; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 43; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 59.

33. Për këto arsye, Trupi Gjykses gjykon se nxjerrja për publikun dhe për palët e çdo materiali apo informacioni që çon në identifikimin e viktimave të pranuar për pjesëmarrje në proces, përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për to dhe për anëtarët e familjeve të tyre. Trupi Gjykses pranon se informacioni në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë ka qenë objekt debati juridik.⁶⁹ Megjithatë, për të njëjtat arsye, Trupi Gjykses gjykon se nxjerrja për Mbrojtjen e identiteteve të dëshmitarëve me status të dyfishtë para shfuqizimit të masave mbrojtëse të cilat janë në fuqi për shkak të statusit të tyre si dëshmitarë të ZPS-së, përbën një rrezik objektivisht të arsyetueshëm për ta dhe për familjet e tyre. Trupi Gjykses gjithashtu gjykon se nxjerrja për publikun e identiteteve të dëshmitarëve me status të dyfishtë – në cilindo qoftë fazë – përbën rrezik objektivisht të arsyetueshëm për ta dhe për familjet e tyre.

34. Sa i përket domosdoshmërisë së masave mbrojtëse, Trupi Gjykses vlerëson se, për arsyet e lartpërmendura dhe në këtë fazë, anonimiteti i trajtuar në rregullën 80(4)(e)(i) për viktimat të cilat nuk janë dëshmitarë me status të dyfishtë, është masë e domosdoshme në këto rrethana. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vlerëson se kodet e dëshmitarëve dhe identitetet e viktimave të pranuar për pjesëmarrje në proces dhe të cilat janë dëshmitarë me status të dyfishtë, duhet t'i nxirren Mbrojtjes për të mundësuar të drejtën e ballafaqimit me dëshmitarët. Për këtë arsye, masat mbrojtëse aktualisht në fuqi për dëshmitarët me status të dyfishtë për shkak të statusit të tyre si dëshmitarë të ZPS-së, përbëjnë masa të domosdoshme.

35. Në lidhje me proporcionalitetin e këtyre masave, Trupi Gjykses thekson se: (i) kodet e dëshmitarëve dhe identitetet e dëshmitarëve me status të dyfishtë do

⁶⁹ *Shih* F01153, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Nxjerrjen e Informacionit të Dëshmitarëve me Status të Dyfishtë* ("Vendimi mbi Dëshmitarët me Status të Dyfishtë"), 13 dhjetor 2022, para. 39.

t'u nxirren të akuzuarve;⁷⁰ dhe (ii) masat mbrojtëse të urdhëruara në këtë fazë në lidhje me cilëndo prej viktimave të pranuar nuk pengojnë ndryshimin e tyre në një fazë të mëvonshme, nëse dhe kur të lindë nevoja.⁷¹

36. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses miraton masën e anonimitetit kundrejt publikut dhe palëve për viktimat e pranuar që nuk janë dëshmitarë me status të dyfishtë. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë, vazhdojnë të vlejnë masat mbrojtëse në fuqi për ta si dëshmitarë të ZPS-së.

(c) Nxjerrja e kodeve të dëshmitarëve me status të dyfishtë

37. Megjithëse gjykon se kodet e dëshmitarëve me status të dyfishtë duhet t'i nxirren Mbrojtjes, Trupi Gjykses vlerëson se para nxjerrjes së tyre, mbrojtësi i viktimave duhet të ketë mundësinë t'i informojë individët përkatës se statusi i tyre si viktimë do t'i bëhet i ditur Mbrojtjes, në mënyrë që ata të mund të ngrenë shqetësimet e tyre, nëse kanë, për nxjerrjen e këtij informacioni.⁷²

38. Për këtë arsye, si dhe për të mundësuar nxjerrjen e informacionit në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë, Trupi Gjykses urdhëron:

(a) mbrojtësin e viktimave të kontaktojë ZPS-në për të identifikuar dëshmitarët me status të dyfishtë të pranuar për pjesëmarrje në proces me anë të këtij vendimi, si dhe të dorëzojë një listë të përditësuar të dëshmitarëve me status të dyfishtë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, deri të **mërkurën, 22 shkurt 2023**, e cila t'i bëhet e ditur ZMMD-së dhe ZPV-së;

⁷⁰ F01199, Mbrojtësi i Viktimave dhe Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Përbashkët i Mbrojtësit të Viktimave dhe ZPS-së në përputhje me Vendimin F01153*, 12 janar 2023, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁷¹ *Shih* Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 69; Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 53; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 45; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 61.

⁷² Vendimi mbi Dëshmitarët me Status të Dyfishtë, para. 41.

(b) mbrojtësin e viktimave të informojë dëshmitarët me status të dyfishtë se fakti që janë viktimë do t'i bëhet i ditur Mbrojtjes kur të bëhet e ditur se janë dëshmitarë të ZPS-së. Në rast se kanë shqetësime, dëshmitarët me status të dyfishtë mund t'i ngrenë ato para Trupit Gjykses. Kërkesat për mjet juridik në lidhje me shqetësimet e ngritura, në qoftë se do të ketë, mbrojtësi i viktimave duhet t'i dorëzojë deri të **mërkurën, 8 mars 2023**; dhe

(c) nëse do të ngrihen shqetësime, dhe në bazë të kompetencës diskrecionale të Trupit Gjykses, lista e dëshmitarëve me status të dyfishtë do të riklasifikohet si konfidenciale.

2. Parashtruesit e Kërkesave të Grupit B

39. Sa i përket rekomandimit të ZPV-së që emrat dhe informacioni identifikues i parashtruesve të kërkesave të Grupit B të mos u bëhen të ditura palëve dhe publikut,⁷³ Trupi Gjykses gjykon se për shkak të konfidencialitetit të procesit të parashtrimit të kërkesës, sikurse përcaktohet në rregullën 113(1)-(2), dhe duke mbajtur parasysh mbrojtjen e privatësisë së parashtruesit të kërkesës, mosnxjerrja për palët dhe publikun e emrave dhe informacionit identifikues të tyre, është e domosdoshme. Trupi Gjykses gjithashtu gjykon se, meqenëse asnjë prej parashtruesve të kërkesave të grupit B nuk është pranuar si viktimë pjesëmarrëse në proces, mosnxjerrja e informacionit të lartpërmendur nuk u shkakton kurrfarë dëmi të akuzuarve.

40. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses urdhëron që emrat dhe informacioni identifikues i parashtruesve të kërkesave të Grupit B të mos nxirren për palët dhe publikun, dhe në përputhje me këtë e gjykon të përshtatshme ruajtjen e

⁷³ Raporti i Gjashtë, para. 74; Raporti i Shtatë, para. 45; Raporti i Tetë, para. 78; Raporti i Nëntë, para. 71; Raporti i Dhjetë, para. 67.

klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të formularëve të kërkesave, përmbledhjeve dhe dokumentacionit mbështetës përkatës.

C. GRUPIMI DHE PËRFAQËSIMI JURIDIK I PËRBASHKËT

41. Sa i përket rekomandimit të ZPV-së që të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A të grupohen bashkë me viktimat e tjera pjesëmarrëse në proces,⁷⁴ Trupi Gjykses rikujton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se nevoja për t'i ndarë parashtruesit në më shumë se një grup del kur situata ose veçantia e viktimave ndryshon aq shumë sa që interesat e tyre janë të papajtueshme, që e bën të përealizueshëm përfaqësimin e përbashkët për ta.⁷⁵

42. Trupi Gjykses vëren se parashtruesit e kërkesave të Grupit A kanë prejardhje të ndryshme, jetojnë në zona të ndryshme dhe flasin gjuhë të ndryshme. Njëkohësisht, të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A, qofshin ata viktimat të drejtpërdrejta dhe/ose jo të drejtpërdrejta, u bënë objekt i krimeve të ngjashme të pretenduara, në rrethana përgjithësisht të ngjashme, dhe pësuan forma të ngjashme dëmi. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se duket se të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A kanë të njëjtin interes të pjesëmarrjes në proces dhe të realizimit të të drejtave të tyre. Gjithashtu, të gjithë këta parashtrues të kërkesave kanë bërë të ditur se nuk kundërshtojnë të jenë në një grup me viktimat e tjera.

43. Bazuar në konstatimet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se të gjithë parashtruesit e kërkesave të Grupit A do të grupohen në Grupin 1, së bashku me viktimat e pranuar më parë.

⁷⁴ Raporti i Gjashtë, para. 65; Raporti i Tetë, para. 71; Raporti i Nëntë, para. 61; Raporti i Dhjetë, para. 57.

⁷⁵ Vendimi i Parë Kornizë, para. 43; Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76. *Shih gjithashtu*, Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 58; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 48; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 69.

44. Gjithashtu, një viktimë (**viktima 180/06**) ka shprehur parapëlqimin të ketë “një mbrojtës kompetent”, një viktimë (**viktima 191/06**) ka shprehur parapëlqimin të përfaqësohet nga [REDAKTUAR], tri viktima (**viktimat 110/06, 191/06 dhe 210/06**) kanë shprehur parapëlqimin të kenë avokatë të përmendur me emër në formularët e kërkesave, dhe viktimat e tjera nuk kanë ndonjë parapëlqim.⁷⁶ ZPV-ja rekomandon që të gjithë parashtruesit e pranuar të kërkesave të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave i caktuar.⁷⁷ Trupi Gjykes është bindur se praktika e rekomanduar është në përputhje me garantimin efektiv të të drejtave të personave në fjalë.

45. Bazuar në të njëjtat vlerësime si ato në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave,⁷⁸ Trupi Gjykes konstaton se Grupi 1 do të përfaqësohet nga mbrojtësi i viktimave i caktuar për Grupin 1.

D. PJESËMARRJA NË GJYKIM

46. Parashtruesit e kërkesave të Grupit A i ushtrojnë të drejtat e tyre përmes mbrojtësit të viktimave dhe marrin pjesë në proces sipas modaliteteve të përshkruara në Vendimin e Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave dhe në përputhje me Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjyimit.⁷⁹

⁷⁶ Raporti i Gjashtë, para. 67; formularët e kërkesave të **viktimave 97/06, 99/06, 100/06, 101/06, 102/06, 103/06, 112/06, 163/06, 121/06, 122/06, 123/06, 124/06, 125/06, 186/06, 187/06, 188/06, 195/06, 197/06, 198/06, 199/06, 200/06, 201/06, 202/06, 203/06, 204/06, dhe 212/06**. Raporti i Tetë, para. 70; formulari i kërkesës i **viktimës 210/06**. Trupi Gjykes vë në dukje se parashtruesit e tjerë të kërkesave në Raportin e Tetë që kanë shprehur preferencat e tyre në lidhje me përfaqësimin juridik (**150/06, 155/06 dhe 190/06**) janë parashtruesit e kërkesave të Grupit B.

⁷⁷ Raporti i Gjashtë, para. 68; Raporti i Tetë, para. 71; Raporti i Nëntë, para. 63; Raporti i Dhjetë, para. 60.

⁷⁸ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 76; *shih gjithashtu*, Vendimi i Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 58; Vendimi i Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 48; Vendimi i Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 69; Vendimi i Parë Kornizë, para. 43.

⁷⁹ Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 82-84, 85(d); F01226/01, Trupi Gjykes, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjyimit*, 25 janar 2023, para. 32-36.

VI. VENDIM

47. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a. **MIRATON** kërkesat e parashtruesve të kërkesave të Grupit A dhe i pranon si viktima pjesëmarrëse në proces;
- b. **RRËZON** kërkesat e parashtruesve të kërkesave të Grupit B si të papranueshme;
- c. **VENDOS** që parashtruesit e kërkesave të Grupit A të përfshihen në Grupin 1 për përfaqësimin e përbashkët të tyre, dhe të përfaqësohen nga mbrojtësi i viktimave për Grupin 1;
- d. **MIRATON** modalitetet e pjesëmarrjes dhe të drejtat e mbrojtësit të viktimave të përcaktuara në paragrafin 73(d) të Vendimit të Katërt mbi Pjesëmarrjen e Viktimave;
- e. **URDHËRON** masat mbrojtëse të mëposhtme sipas rregullës 80(4)(e)(i):
 - i. anonimitet për parashtruesit e kërkesave të Grupit A që nuk janë dëshmitarë me status të dyfishtë;
 - ii. të njëjtat masa mbrojtëse për parashtruesit e kërkesave të Grupit A që janë dëshmitarë me status të dyfishtë, me ato të cilat u janë miratuar si dëshmitarë të ZPS-së; dhe
 - iii. mosnxjerrjen për palët dhe publikun të emrave dhe çfarëdo informacioni tjetër identifikues të parashtruesve të kërkesave të Grupit B, si dhe mbajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të formularëve të kërkesave, përmbledhjeve dhe dokumentacionit mbështetës të secilit prej tyre;
- f. **VENDOS** mbajtjen e klasifikimit rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* për të gjithë formularët e kërkesave, përmbledhjet e kërkesave dhe

dokumentacionin mbështetës, në varësi të një urdhri të mëtejshëm në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë;

- g. **URDHËRON** mbrojtësin e viktimave që në lidhje me dëshmitarët me status të dyfishtë:
- i. të kontaktojë ZPS-në për të identifikuar dëshmitarët me status të dyfishtë dhe të dorëzojë një listë të përditësuar të dëshmitarëve me status të dyfishtë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, deri të **mërkurën, 22 shkurt 2023**, e cila t'i bëhet e ditur ZMMD-së dhe ZPV-së;
 - ii. të informojë dëshmitarët me status të dyfishtë se statusi i tyre si viktimë do t'i bëhet i ditur Mbrojtjes, në përputhje me këtë vendim;
 - iii. t'i paraqesë Trupit Gjykses çfarëdo shqetësimi të mundshëm të ngritur nga dëshmitarët me status të dyfishtë, deri të **mërkurën, 8 mars 2023**; dhe
 - iv. në rast se nuk janë ngritur shqetësime, të riklasifikojë si konfidenciale listën e dëshmitarëve me status të dyfishtë, një ditë pas afatit të lartpërmendur.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E martë, 15 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë.